

FSDK shënon bashkëpunimin teknik me BERZH për zhvillim të sistemit për kompensim të depozitorëve

Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë "FSDK" dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim "BERZH" shënuan bashkëpunimin teknik për zhvillimin e sistemit për kompensim të depozitorëve. Projekti bazohet në Marrëveshjen e Grantit të nënshkruar në vlerë prej €256 mijë, me grant nga BERZH-i prej €230 mijë dhe bashkëfinancim nga FSDK prej €25 mijë. Projekti i bashkëpunimit teknik me BERZH-in realizohet në kuadër të Marrëveshjes së Kredisë për linjën kreditore për FSDK në vlerë prej €10 milionë, të garantuar plotësisht nga Republika e Kosovës, përmes Ministrisë së Financave.

Në hapje të konferencës Kryesuesja e Bordit Menaxhues të FSDK-së, Zonja Shkendije Himaj-Zekaj në emër të Bordit Menaxhues të FSDK-së uroi mirëseardhje të pranishmëve duke theksuar se ngjarja e sotme që organizohet në vitin e pestë të themelimit, përveç shpalosjes së raportit vjetor për vitin 2015, gjithashtu shënon ngjarje me rëndësi të veçantë për zhvillimin e FSDK-së. Për të hapur konferencën Zonja Shkendije Himaj-Zekaj ftoi Ministrin e Financave Zoti Avdullah Hoti për fjalim.

Në fjalimin hyrës të Konferencës, Ministri i Financave Zoti Avdullah Hoti fillimisht theksoi "rëndësinë e ngjarjes dhe në emër të Qeverisë së Kosovës shprehu mirënjohjen ndaj BERZH-it për mbështetje të FSDK-së". Më tutje, Ministri Hoti theksoi "rëndësinë institucionale të FSDK-së, si hallkë e rëndësishme e rrjetit të sigurisë financiare, dhe në pajtim me rekomandimet e dala nga vlerësimi i pajtueshmërisë me Parimet Themelore për sisteme efektive të sigurimit të depozitave mirëprent iniciativën e FSDK-së për adresimin e aranzhimit për financim emergjent, ku Ministria e Financave ka miratuar në parim mbështetjen me garancion shtetëror për një linjë të dytë kreditore me BERZH-in". Në fund Ministri Hoti përgëzoi bashkëpunimin e suksesshëm dhe "siguroi që Ministria e Financave do të vazhdojë mbështetjen e vazhdueshme ndaj FSDK-së".

Zoti Fehmi Mehmeti, Zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës fillimisht përgëzoi shënimin e "marrëveshjes me rëndësi të madhe në mes të Fondit dhe BERZH-it për zhvillimin e sistemit për kompensim të depozitorëve", dhe duke e njohur "Fondin si një ndër katër shtyllat kyçe për mbështetje efektive të stabilitetit të sektorit financiar, vuri në theks rritjen e limitit të sigurimit të depozitave në €4,000 nga 1 janari 2016 dhe planifikimin e rritjes në €5,000 nga 1 janari 2018, e cilësuar adekuate për Kosovë". Më tutje, Zoti Mehmeti mirëpriti "rezultatet e vlerësimit të pajtueshmërisë me Parimet Themelore ndërkombëtare, ku sistemi është vlerësuar në pajtueshmëri me shumicën e parimeve dhe theksoi që përkrahja nga BERZH-i për zhvillimin e sistemit për kompensim të depozitorëve do të mundëson proces të shpejtë dhe efikas të kompensimit duke rritur besimin e depozitorëve si faktor kryesor në stabilitetin financiar".

Ngjashëm, Zonja Elena Petrovska, Udhëheqëse e Zyrës Rezidente të BERZH-it në Prishtinë, tha: "Ky projekt do të rrisë besimin e depozituesve që është themeli kryesor i çdo sektorit të shëndoshë bankar. Besimi është vlera kryesore më e çmueshme në sektorin bankar. Ajo duhet ndërtuar përgjatë viteve dhe kultivuar vazhdimisht. Skema depozitave është element i rëndësishëm i cili do të forcojë më tej sektorin financiar vendor. Njëkohësisht është themeli për zhvillimin e shëndoshë dhe të qëndrueshëm të ekonomisë së gjerë. Bashkëpunimi teknik është tipar i veçantë që BERZH-i mund të ofrojë për klientët e saj duke falënderuar donatorëve të saj.

Këto programe janë të dizajnuara për të siguruar shërbime këshilluese dhe luajnë një rol të rëndësishëm në plotësimin e aktiviteteve tona të një investitori”.

Ndërsa, Zoti Ilir Aliu, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave në Kosovë, fillimisht theksoi mirënjohjen për Qeverinë e Kosovës (përmes Ministrisë së Financave) dhe Qeverinë Gjermane (përmes KfW-së) për mbështetjen në themelimin e sistemit për sigurim të depozitave dhe mirëpriti përkrahjen e tanishme nga BERZH-i”. Më tutje duke theksuar indikatorët e stabilitetit të sektorit bankar”, shprehu “mbështetjen e Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe bashkëpunimin në implementim të projektit dhe i “falënderoj të gjitha palët që janë duke kontribuar në rritjen e stabiliteti të sektorit bankar”.

Duke vlerësuar zhvillimin e sigurt të Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë, si institucion i pavarur, gjatë pesë viteve të para të funksionimit, z. Jeton Arifi, Drejtor në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në fjalën e tij të rastit, e krahasoi atë me institucionin që përfaqëson ai, i cili, njëjti si FSDK, sapo ka shënuar pesë vjetorin e themelimit të tij. Mes tjerash, ai u shpreh se çmon bashkëpunimin ndërinstytucional, në veçanti të institucioneve financiare, duke i vënë theks të veçantë konstruktivitetit që FSDK ka treguar gjatë kësaj periudhe në raport me ASHMDHP-në, duke mbajtur relacione të afërta përmes zyrtares për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllimin e vetëm që përpunimi i të dhënave personale të depozitorëve të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përfundim të Konferencës, Drejtoresha Menaxhuese, znj. Violeta Arifi-Krasniqi, prezantoi pikat kryesore të raportit vjetor për vitin 2015, duke dhënë një përmbledhje të progresit pesëvjeçar përshtirë indikatorëve kryesorë, karakteristikat e sistemit të sigurimit të depozitave dhe performancën financiare. Fondi i Sigurimit të Depozitave në fund të vitit 2015 ka arritur në €26.9 milionë nga të cilat €17.5 milionë janë kontribute kapitale në formë granti dhe €9.4 milionë janë surplus të akumuluar nga pagesat e premiumeve nga bankat anëtare. Nga gjithsej €17.5 milionë kontribute kapitali, €11 milionë janë dhënë nga Qeveria e Kosovës (përmes Ministrisë së Financave) dhe €6.5 milionë nga Qeveria Gjermane (përmes KfW-së) me qëllim të krijimit të Sistemit të Sigurimit të Depozitave si dhe të mbështetjes së rritjes së limitit të sigurimit të depozitave.

Trend i ngjashëm i rritjes së depozitave është shënuar, duke treguar besimin e vazhdueshëm të publikut në sektorin bankar, ku depozitat në sektorin bankar të Kosovës janë rritur për 6.2% në €2.65 miliardë (bazuar në raportimin e veçantë të bankave anëtare të FSDK-së), si dhe rritje të depozitave të siguruar për 9.4% në €494 milionë (në nivelin e sigurimit të depozitave prej €3,000), në krahasim me vitin 2014. Aktualisht, në nivelin e sigurimit të depozitave prej €3,000, FSDK siguron rreth 847 mijë depozitorë (ose 97%) në nëntë banka anëtare që përbëjnë një vëllim të përgjithshëm të depozitave të siguruar prej €494 milionë (ose 18.67%) më 31 dhjetor 2015.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka për objektivar primar krijimin dhe mbarëvajtjen e një sistemi të qëndrueshëm financiar në Kosovë, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndoshë dhe efikas të pagesave. Në licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimi e bankave kosovare, Banka Qendrore i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së interesave të depozitorëve. Bashkëpunimi ndërmjet Bankës Qendrore dhe FSDK-se për sa i përket shkëmbimit të informacioneve dhe çështjeve tjera të interesit reciprok rregullohet me anë të Memorandumit të Mirëkuptimi. Banka

Qendrore ka qenë iniciatore i krijimit të skemës dhe ka ofruar në mënyrë intensive burime njerëzore dhe teknike për të mbështetur themelimin, si dhe operacionalizimin e FSDK-së.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

BERZH është themeluar në vitin 1991 për të investuar në zhvillimin e sektorit privat dhe për të nxitur kalimin në ekonomitë e tregut. Në pronësi të 65 aksionarëve ndërkombëtarë, sot Banka operon në 35 vende duke filluar nga Maroko deri në Mongoli dhe nga Estonia deri në Egjipt. Deri më sot, BERZH ka investuar mbi € 105 miliardë në 4,500 projekte, duke ofruar projekte të financimit të për bankat, industrinë dhe bizneset, si në sipërmarrje të reja dhe investimet në kompanitë ekzistuese.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe institucionet private për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale.

Shoqata e Bankave të Kosovës

Shoqata e Bankave (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Kosovë. Bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik me qëllim mbështetjen e një industrie të shëndoshë bankare e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencon iniciativat ligjore dhe rregullative; koordinon aktivitete të përbashkëta për bankat si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. SHBK përfaqëson shtatë banka komerciale si dhe një institucion mikrofinanciar. Anëtarësimi është i hapur edhe për institucionet financiare jobankare. E themeluar në vitin 2000, Shoqata është bërë pikë kryesore e referimit në lidhje me çështjet që prekin sektorin bankar në Kosovë.

Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK)

Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK) menaxhon sistemin e sigurimit të depozitave në Kosovë me mandate kryesor sigurimin e depozitorëve dhe garantimin e kompensimit në rast të revokimit të licencës dhe mbylljes së bankës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). FSDK gjithashtu mbështet BQK në mbajtjen e stabilitetit të sistemit financiar duke ruajtur besimin e depozitorëve në sistemin bankar. Fondi siguron depozitat e personave fizik dhe personave juridik deri në nivelin maksimal të mbulesës prej 3,000 Euro (me ngritje €4.000 nga 01.01.2016; dhe në €5.000 nga 01.01.2018) dhe kompenson çdo depozitor të siguruar brenda 30 ditëve në të revokimit të licencës dhe mbylljes së bankës.